

1.3.1	Pikovit
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Pikovit® shurup Shurup multivitaminor për fëmijë

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërën me kujdes sepse përmban informata të rëndësishme për ju.

Ky bar është në dispozicion pa recetë. Megjithatë, ju duhet të merrni Pikovit me kujdes për të përfituar rezultatet më të mira prej tij.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje ose kërkon këshilla të tjera, drejtojeni farmacistit.
- Duhet t'a kontaktoni mjekun nëse simptomat ju përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 30 ditësh.
- Nëse cilido nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Pikovit dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Pikovit
3. Si të merrni Pikovit
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Pikovit
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË PIKOVIT DHE PËR SE PËRDORET

Pikovit shurup përmban nëntë vitaminat esenciale të cilat rregullojnë shumë procese biokimike në organizëm. Vitaminat e grupit B (B₁, B₂, B₆, acidi pantotik dhe nikotinamidi) marrin pjesë në metabolizmin e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrnave, si dhe në funksionimin e sistemit nervor. Vitamina A është e nevojshme për zhvillimin e qelizave epiteliale dhe sintezën e pigmentit të pamurit. Vitamina D rregullon përdorimin e kalciumit duke ndihmuar kështu në mineralizimin e kockave dhe të dhëmbëve. Vitamina C përshpejton absorbimin e hekurit dhe përfshihet në shumë procese të reduktimit e oksidimit në organizëm.

Pikovit shurupi mbulon nevojat e organizmit për vitamina dhe kompenson humbjen e tyre në dieta ku masat e përgjithshme (dietë e zakonshme dhe e llojllojshme) nuk janë të mjaftueshme.

Pikovit shurupi përdoret kryesisht për fëmijë:

- në ulje të apetitit,
- në lodhjet e tepërta të fëmijëve që shkojnë në shkollë,
- në rritjen e retarduar,
- si shtesë pas trajtimit me antibiotikë,
- si suplement dietetik me vitamina, posaçërisht në kohën e dimrit dhe pranverës.

Pikovit shurupi nuk është zëvendësim për një dietë të balancuar dhe të llojllojshme. Për këtë arsye është e rëndësishme që fëmiju juaj edhe gjatë marrjes së Pikovit shurupit të ketë dietë të balancuar dhe të llojllojshme.

2. PARA SE TË MERRNI PIKOVIT

Mos merrni Pikovit

- nëse jeni të mbindjeshëm ndaj substancave aktive ose ndaj ndonjë prej përbërësve të Pikovit-it,

PI Text045387_1	30.03.2023 - Updated: 30.03.2023	Page 1 of 4
-----------------	----------------------------------	-------------

1.3.1	Pikovit
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



- nëse keni hipervitaminozë A dhe D.

Tregoni kujdes të veçantë me Pikovit

- nëse jeni me diabet (sëmundja e sheqerit), Pikovit nuk rekomandohet për ju për shkak se 5 ml (1 lugë matëse) shurup përmban 3 g sheqer, dhe një dozë ditore (10 ml deri në 20 ml) përmban 6 g deri në 12 g sheqer.

Nëse paraqitet reaksion i mbindjeshmërisë, ndërprisni marrjen e barit.

Para marrjes në të njëjtën kohë të preparateve tjera të vitaminave, vitamino-mineraleve këshillohuni me mjekun ose farmacistin.

Fëmijëve nën moshën 1 vjeçare mund të ju jepet Pikovit shurup me këshillën dhe nën mbikëqyrjen e mjekut.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Nuk ka pasur raportime që ky bar të ndikojë në efektin e barnave tjera.

Marrja e Pikovit me ushqim dhe pije

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Gratë shtatzëna dhe nënat që ushqejnë me gji fëmijun mund ti marrin vitaminat me këshillën e mjekut. Dozat e vitaminës në Pikovit shurupin janë të përshtatura për fëmijë.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna se Pikovit ndikon në aftësinë për të drejtuar automjete ose për të përdorur makineri.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Pikovit

Pikovit përmban sukrozë, glukozë, azo ngjyruetit E124, benzoat natriumi (E211) dhe natrium.

Nëse mjeku ju ka thënë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni mjekun tuaj para se të merrni këtë bar. Mund të jetë i dëmshëm për dhëmbët.

1 lugë matëse (5 ml) shurup përmban 3,3 g sukrozë. 2 lugë matëse (10 ml) shurup përmbajnë 6,6 g sukrozë. Kjo duhet të merret parasysh tek pacientët me diabet mellitus.

Azo ngjyrueti E124 mund të shkaktojë reaksione alergjike.

Benzoati i natriumit (E211) mund ta rrisë verdhëzën (zverdhjen e lëkurës dhe të syve) tek foshnjat e porsalindura (deri në 4 javë).

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për dozë, domethënë në thelb është 'pa natrium'.

3. SI TË MERRET PIKOVIT

Gjithmonë merrni Pikovit saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Doza e zakonshme për fëmijët nga mosha 1 deri në 3 vjeç është 1 lugë matëse (5 ml) të shurupit dy herë në ditë, për fëmijët nga mosha 4 deri në 6 vjeç 1 lugë matëse (5 ml) të shurupit tre herë në ditë,

1.3.1	Pikovit
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



dhe për fëmijët nga mosha 7 deri në 14 vjeç është 1 lugë matëse (5 ml) të shurupit tre herë, maksimum 4 herë në ditë.

Pikovit shurupi fëmijëve duhet dhënë pas ushqimit me lugën matëse ose të përzier më çaj, lëngë ose me fruta të shtydura.

Në rast të mungesës së apetitit, fëmiju duhet të merr shurupin për 1 muaj, ndërsa në gjendjet tjera duhet të merret sipas nevojës.

Nëse keni përshtypjen se efekti i Pikovit shurupit është shumë i fortë ose shumë i dobët konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Nëse merrni Pikovit më shumë se ç'duhet

Nëse mirret në doza të rekomanduara, nuk mund të vie deri te helmimi.

Marrja për një kohë të gjatë e dozave të larta mund të shkaktojë hipervitaminozë A dhe D, megjithëse mundësia e mbidozimit me Pikovit shurup është minimale.

Nëse harroni të merrni Pikovit

Mos merrni dozë të dyfishtë për të kompenzuar dozën e harruar.

Nëse e ndërprisni marrjen e Pikovit

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtoheni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Pikovit mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Efekte anësore shumë të rralla (në më pak se 1 në 10.000 pacientë):

- reaksione të mbindjeshmërisë. Nëse reaksionet e mbindjeshmërisë paraqiten, ndërpreni marrjen e shurupit dhe bisedoni me mjekun apo farmacistin.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET PIKOVIT

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Pikovit pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C.

Ruajeni në paketim origjinal të mbrojtur nga drita.

Pas hapjes së shishes, shurupi duhet të përdoret brenda 2 muajve.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

1.3.1	Pikovit
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Pikovit

Substancat aktive janë : vitaminë A, kolekalciferol, acid askorbik, tiaminë hidroklorur, riboflavinë natrium fosfat, piridoksinë hidroklorur, ciankobalaminë, nikotinamid, deksapantenol.

5 ml shurup (1 lugë matëse) përmban:

- 900 I.U. vitaminë A (vitaminum A) si retinil palmitat,
- 100 I.U. kolekalciferol (cholecalciferolum, vitamin D₃),
- 50 mg acid askorbik (acidum ascorbicum, vitamin C),
- 1 mg tiaminë hidroklorur (thiamine hydrochloridum, vitamin B₁),
- 1 mg riboflavinë natrium fosfat (riboflavin natrii phosphas, vitamin B₂),
- 0,6 mg piridoksinë hidroklorur (pyridoxini hydrochloridum, vitamin B₆),
- 1 µg ciankobalaminë (cyanocobalaminum, vitamin B₁₂),
- 5 mg nikotinamid (nicotinamidum) dhe
- 2 mg deksapantenol (dexpanthenolum).

Përbërësit e tjerë janë: agar, tragakant (E413), sukrozë, glukozë e lëngët, vaj me aromë portokalli, koncentrat portokalli, koncentrat grejpfruti, polisorbitat 80 (E433), monohidrat i acidit citrik (E330), ngjyruet i kuq 4R (E124), benzoat natrium (E211), ujë i pastruar.

Si duket Pikovit dhe përbërja e paketimit

Pikovit shurupi është me ngjyrë portokalli dhe me shije të këndshme.

Pikovit gjendet në kuti me shishe prej 150 ml shurup dhe me lugë matëse.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet pa recetë të mjekut.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

Mars, 2023